



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government



Ministria e Punëve të Brendshme / Ministarstvo Unutrašnjih Poslova
Ministry of Internal Affairs

Akademia e Kosovës për Siguri Publike
Fakulteti për Siguri Publike
Kosovska Akademija za Javnu Bezbednost / Kosovo Academy for Public Safety

DORACAKU PËR STUDENT TË
FAKULTETIT TË SIGURISË
PUBLIKE

Vushtrri, 2025

PËRMBAJTJA

1. HISTORIKU I THEMELIMIT TË FAKULTETIT PËR SIGURI PUBLIKE	3
2. VENDODHJA E KAMPUSIT	3
3. FAKULTETI PËR SIGURI PUBLIKE.....	4
4. KËSHILLI I FAKULTETIT TË SIGURISË PUBLIKE.....	5
5. PROGRAMI STUDIMOR NIVELI BACHELOR NË AKSP.....	5
6. PËRSHKRIMI I PËRGJITHSHËM I PROGRAMIT.....	5
7. STRUKTURA E PROGRAMIT STUDIMOR	7
8. KUSH KA TË DREJTË TË STUDIOJ NË FAKULTETI E SIGURISË PUBLIKE	11
9. KUSHTET E REGJISTRIMIT TË VITIT AKADEMIK.....	12
10. STATUSI I STUDENTIT.....	12
11. KALENDARI AKADEMIK	13
12. PROGRAMI I LËNDËS – SYLLABUSI.....	13
13. VLERËSIMI I STUDENTVE.....	14
14. AFATET E PROVIMEVE.....	14
15. PËRCAKTIMI I NOTËS	14
16. E DREJTA E ANKESËS LIDHUR ME VLERSIM.....	15
17. SISTEMI PËR MENAXHIM E FAKULTETIT (SMU).....	15
18. SHËRBIMET STUDENTORE NË KUADËR TË AKSP-FSP.....	16
19. TË DREJTAT DHE OBLIGIMET E STUDENTVE	16
20. INSTITUCIONI I OMBUDSPERSONIT – MBROJTËSI I TË DREJTAVE TË	17
21. MOBILITETI I STUDENTVE	18
22. ALUMMNI	18
23. KËSHILLI I STUDENTVE NË FSP	19
24. PROCEDURA E DIPLOMIMIT.....	19
25. KAMPUSI I AKSP.....	20

HISTORIKU I THEMELIT TË FAKULTETIT PËR SIGURI PUBLIKE

Krahas aprovimit të Ligjit të AKSP në dhjetor të vitit 2011, Komisioni Evropian ka aprovuar dhe financuar Projektin e Binjakëzimit me titull: “Përmirësimi i arsimit në sektorët e sigurisë dhe rendit publik” implementuar gjatë periudhës 2012 - 2014 nga Finlanda dhe Estonia.

Përmes projektit të binjakëzimit u bë e mundur themelimi i Arsimit të Lartë në fushën e sigurisë publike për të gjithë zbatuesit e ligjit, në përputhje me procesin e Bilonjës, përkatësisht me standardet evropiane, diçka që më parë nuk kishte ekzistuar jo vetëm në Akademi, por as në Kosovë dhe në Regjion.

Gjatë periudhës 2012 - 2014, në kuadër të projektit të binjakëzimit në Akademi u realizuan një mori procesesh të rëndësishme: Kompletohet korniza ligjore; hartohet raporti i vetëvlerësimit, dizajnohet kurrikula për Bachelor në sigurinë publike, dizajnohet struktura e programit studimor katër vjeçar (240 ECTS), niveli Bachelor(BA), hartohet “Doracaku i Cilësisë” dhe Sistemi i Sigurimit të Cilësisë, hartohet “Strategjia Zhvillimore e Akademisë dhe Plani i Veprimit”, për vitet 2014 - 2018, rekrutohet stafi i përhershëm akademik në (mars 2014), merret vendimi i akreditimit të programit studimor katër vjeçar (240 ECTS) për Akademinë në fushën e sigurisë publike nga Këshilli Shtetëror i Cilësisë dhe i kumtuar nga Agjencia e Akreditimit e Kosovës.

Realizimi i të gjitha këtyre proceseve, bënë të mundshme që në Akademi të themelohet arsimi i lartë në fushën e sigurisë publike.

Studentë janë nga Institucionet e Sigurisë Publike përkatësisht nga: Policia e Kosovës, Inspektorati Policor i Kosovës, Agjencia e Menaxhimit Emergjent, Shërbimi Korrektues i Kosovës, Shërbimi Sprovues i Kosovës dhe Dogana e Kosovës.

VENDNDODHJA E KAMPUSIT

AKSP-FSP ka selinë e saj në qytetin e Vushtrrisë ku edhe gjendet kampusi i saj në adresën: Rr. “Gjergj Kastrioti Skënderbeu” p.n. 42000 Vushtri, Republika e Kosovës.



(Foto Nr.1 Ambienti i AKSP, pamje nga perspektiva lartë)

FAKULTETI PËR SIGURI PUBLIKE

Në kuadër të strukturës organizative të Akademisë funksionon Fakulteti i Sigurisë Publike i cili zhvillon programe të arsimit të lartë, hulumtimit dhe zhvillimit në fushën e sigurisë publike. Misioni i Fakultetit është të ofrojë shërbime cilësore të arsimit, hulumtimit dhe zhvillimit për siguri publike në Republikën e Kosovës.

Studimet bachelor në AKSP/FSP ofrohen aktualisht për pjesëtarët e agjencive të sigurisë publike dhe janë falas dhe pa shkëputje nga puna në këto agjenci:

- Policia e Kosovës.
- Inspektorati Policor
- Shërbimi Korrektues i Kosovës
- Shërbimi Sprovues i Kosovës
- Dogana e Kosovë
- Menaxhimi Emergjent.

MËNYRA E STUDIMIT NË FSP - Për studentët që vijojnë studimet në programin bachelor në AKSP/FSP, mënyra e studimit është si në vijim:

- Pjesa teorike (ligjëratat) vijohet në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike.
- Pjesa praktike (Internshipi) vijohet pas përfundimit të ligjëratave në Institucionet e Sigurisë më së largu deri më 30 shtator të çdo viti përkatës akademik duke u bazuar në plan programin mësimor.

KËSHILLI I FAKULTETIT TË SIGURISË PUBLIKE

Këshilli është organi më i lartë akademik i Fakultetit i cili vendos për të gjitha çështjet e rëndësishme të Fakultetit në fushën e mësimi, kërkimit dhe hulumtimit shkencor.

Detyrat dhe përgjegjësitë e Këshillit janë të përcaktuar sipas Rregullores për Arsimin e lartë në AKSP dhe Rregullores së punës së Këshillit të Fakultetit të Sigurisë Publike si në vijim:

- Të trajtojë çështjet e përgjithshme që lidhen me kërkime, studime dhe mësimdhënie në Fakultet;
- T'i japë këshilla dhe propozime Bordit të Akademisë dhe Drejtorit për të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me Fakultetin;
- Të mbikqyrë progresin e studentëve si dhe të kërkimeve shkencore;
- Të vendosë për veprimtarinë mësimore dhe shkencore të Fakultetit;
- Të miratoj programet studimore pas marrjes së pëlqimit nga Bordi i Akademisë;
- Të shqyrtojë çështje të ndryshme akademike të inicuar nga Drejtori dhe Bordi i Akademisë;
- Të kryejë edhe punë tjera të caktuara me aktet normative që rregullojnë fushëveprimin e Akademisë.

PROGRAMI STUDIMOR - NIVELI BACHELOR

Programi studimor për nivelin “bachelor” është hartuar sipas nevojave të institucioneve të sigurisë publike në pajtim me legjislacionin në fuqi, me politikat e arsimit të lartë në Kosovë dhe është bazuar në kompetencë, shkathtësi dhe njohuri, të kërkuara për punë profesionale.

Fakulteti i Sigurisë Publike në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike, ka krijuar mundësi të mëdha për të zyrtaret e Institucioneve të Sigurisë, të cilët duke u bërë pjesë e këtij institucioni të arsimit të lartë në Kosovë, kontribuojnë në ngritjen e kapaciteteve dhe njëkohësisht kontribuojnë në shërbime të qytetarëve, stabilitet dhe siguri në vend.

PËRSHKRIMI I PËRGJITHSHËM I PROGRAMIT

Emërtimi i programit	Siguri Publike
Institucioni bartës	Akademia e Kosovës për Siguri Publike - Fakulteti i Sigurisë Publike

Niveli i studimeve	Studime themelore (Bachelor), niveli 6 sipas KKK/EQF
Kohëzgjatja e studimeve	3 vite (6 semestra)
Vëllimi i programit	180 ECTS
ECTS për vit studimi	60 ECTS
Forma e studimeve	Studime të rregullta pa shkëputje nga puna
Qëllimi i programit	Përgatitja e profesionistëve të sigurisë publike me njohuri të thelluara teorike dhe praktike për policinë, doganat, shërbimin korrektues e sprovues, menaxhimin emergjent dhe inspektoratin policor, në përputhje me standardet bashkëkohore dhe legjislacionin e Kosovës.
Struktura e programit	Çdo vit akademik përmban 60 ECTS, në përputhje me standardet e EHEA/Procesit të Bolonjës. Cdo Semestër i ka nga: 5 lëndë obligative dhe 1 lëndë zgjedhore (nga 3 të ofruara) ndërsa Semestri VI: 1 lëndë obligative, 1 lëndë zgjedhore (nga 2 të ofruara), Internship III dhe tema e diplomës. Programi përfshin fazat e mëposhtme: I. Studime bazike dhe hyrëse në fushën e sigurisë publike; II. Studime për zhvillimin dhe thellimin e njohurive në fushën e sigurisë publike; III. Studime të specializuara në fushën e sigurisë publike; IV. Periudha e praktikës profesionale (Internship I, II, III); V. Periudha hulumtuese (punimi i diplomës).
Grupi i synuar	Zyrtarët e institucioneve të sigurisë publike të Republikës së Kosovës, që janë aktiv në punë dhe posedojnë përvojë relevante në nivel operacional ose mbështetës.
Kushtet e pranimit	1) Shkolla e mesme 2) Punësimi në institucionet e sigurisë publike; 3) Tre (3) vite përvojë pune në institucionet e sigurisë publike.
Diploma që jepet	Bachelor në Siguri Publike

STRUKTURA E PROGRAMIT STUDIMOR

Programi “Siguri Publike” është program tre (3) vjeçar, i ndarë në gjashtë (6) semestra, ku studenti duhet të akumulojë 180 ECTS për kryerjen e suksesshme të programit. Programi është i strukturuar në mënyrë të balancuar ndërmjet përmbajtjes teorike dhe përgatitjes praktike profesionale. Studentët ndjekin një program të integruar studimi, me kurrikulë të përbashkët që përfshin: 135 ECTS nga lëndët teorike (obligative dhe zgjedhore); 30 ECTS nga pjesa praktike, e realizuar përmes tre fazave të praktikës profesionale (internship), nga 10 ECTS secila, të ndara në fund të çdo viti akademik dhe Tema e Diplomës që përfshin 15 ECTS.

Kategoria e lëndëve	Totali ECTS
Lëndë obligative	111 ECTS
Lëndë zgjedhore*	24 ECTS
Internship (3 nivele)	30 ECTS
Temë diplome	15 ECTS
Totali i programit	180 ECTS

* Një lëndë zgjedhore duhet të përzgjidhet nga së paku 10 studentë.

Tabela 1 - Shpërndarja e ECTS sipas kategorive të lëndëve

Struktura e programit studimor është e dizajnuar në këtë mënyrë:

- I. Studime bazike dhe hyrëse në fushën e sigurisë publike
- II. Studime për zhvillimin dhe thellimin e njohurive në fushën e sigurisë publike
- III. Studime të specializuara në fushën e sigurisë publike
- IV. Periudha e praktikës profesionale
- V. Periudha hulumtuese

Viti III	Periudha e tretë e punës praktike (Internship III) 10 ECTS		60 ECTS	180
	Studime të specializuara në fushën e sigurisë publike 31 ECTS	Periudha hulumtuese 19 ECTS (Metodologjia e hulumtimit shkencor dhe Tema e Diplomës)		
	↑			
	Periudha e dytë e punës praktike (Internship II) 10 ECTS		60	

Viti II	Studime për zhvillimin dhe thellimin e njohurive në fushën e sigurisë publike 50 ECTS	ECTS	ECTS
	↑		
Viti I	Periudha e parë e punës praktike (Internship II) 10 ECTS	60 ECTS	
	Studime bazike dhe hyrëse në fushën e sigurisë publike 50 ECTS		

Tabela 2 - Struktura e programit studimor

I.Studime bazike dhe hyrëse në fushën e sigurisë publike

Viti i parë i studimeve përfshin semestrin e parë dhe të dytë, që përfshin secili nga 25 ECTS për lëndët teorike. Në secilin semestër të vitit të parë, lëndët teorike përbëhen nga pesë (5) lëndë obligative dhe tri (3) lëndë zgjedhore, nga të cilat studenti zgjedh një (1) lëndë për ta ndjekur në secilin semestër. Ky vit synon t’u ofrojë studentëve bazat teorike dhe njohuritë hyrëse për të kuptuar konceptet juridike, institucionale, organizative dhe shoqërore që lidhen me sigurinë publike.

Përmes kombinimit të fushave të ligjit, të sigurisë, të politikave të sigurisë dhe disiplinave mbështetëse multidisiplinare, studentët ndërtojnë formim të qëndrueshëm për të kuptuarit e funksionimit të sistemit të sigurisë publike, si dhe kuadrin ligjor që rregullon atë. Në këtë vit, studentët formohen dhe zhvillohen për aspektet menaxheriale, etike dhe psikologjike, të cilat janë të nevojshme për të kuptuarit e udhëheqjes, vendimmarrjes dhe bashkëpunimit në aspektin profesional profesional. Kjo pjesë u mundëson studentëve për tu përgatitur dhe arritur aftësi për aspektet gjuhësore të gjuhës angleze si gjuhë e dytë, pastaj të shkrimit akademik, si dhe të komunikimit dhe zgjidhjes konflikteve. Ndërsa përmbajtjet me fokus social dhe psikologjik u ndihmojnë të kuptojnë dimensionet njerëzore dhe sfidat e mjediseve të sigurisë publike.

II. Studime për zhvillimin dhe thellimin e njohurive në fushën e sigurisë publike

Viti i dytë i studimeve përfshin semestrin e tretë dhe të katërt, që përfshin secili nga 25 ECTS për lëndët teorike. Në secilin semestër të vitit të parë, lëndët teorike përbëhen nga pesë (5) lëndë obligative dhe tri (3) lëndë zgjedhore, nga të cilat studenti zgjedh një (1) lëndë për ta ndjekur në secilin semestër. Ky vit ka për qëllim thellimin dhe zgjerimin e njohurive të fituara në vitin e parë, duke kaluar nga konceptet bazë në analiza të avancuara dhe zhvillimin e aftësive profesionale.

Programi përfshin fusha të së drejtës dhe të sigurisë publike, duke mundësuar kuptim të thelluar të kornizës juridike që rregullon veprimtarinë e sigurisë publike, si dhe aftësi për menaxhimin e krizave, politikave të sigurisë dhe parandalimit të krimit. Studentët fitojnë njohuri mbi parandalimin, hetimin dhe menaxhimin e fenomeneve kriminale, duke kombinuar aspektet juridike, të sigurisë dhe të politikave operative. Dimensioni multidisiplinar dhe ai i aftësive mbështetëse forcohet përmes zhvillimit të kompetencave në inteligjencë, psikologji, sjellje organizative dhe komunikim profesional, duke lidhur teorinë me praktikën dhe për t'i përgatitur studentët për vitin e tretë.

III. Studime të specializuara në fushën e sigurisë publike

Viti i tretë i studimeve përfshin semestrin e pestë dhe të gjashtë, me një strukturë të përshtatur për specializim dhe përgatitje për përfundimin e programit studimor. Në semestrin e pestë, studenti ndjek pesë lëndë obligative dhe zgjedh një nga katër lëndët zgjedhore, ndërsa në semestrin e gjashtë duhet të ndjek një lëndë obligative dhe zgjedh një nga dy lëndët zgjedhore.

Ky vit fokusohet në zhvillimin e njohurive të avancuara dhe të specializuara, duke përgatitur studentët për të analizuar dhe menaxhuar sfidat komplekse të sigurisë publike. Programi trajton aspekte të sigurisë kombëtare, si elemente të sigurisë ndërkombëtare, përkatësisht rreziqet bashkëkohore, menaxhimin e krizave dhe përdorimin e teknologjive të avancuara në siguri. Gjithashtu, studentët zhvillojnë kompetenca praktike, menaxheriale dhe të bashkëpunimit ndërkombëtar, duke u përgatitur për zbatimin e politikave operative dhe për përballje me sfidat e ndërlidhura globalisht. Kjo fazë shërben si bazë për integrimin e njohurive në praktikën profesionale dhe punën hulumtuese që përmbyllet me temën e diplomës.

IV. Periudha e praktikës profesionale

Periudha e praktikës profesionale (internship) përbën 1/6 e programit të studimeve, përkatësisht 30 ECTS në total. Në semestrin veror të secilit vit akademik, studenti është i obliguar të ndjekë praktikën profesionale dhe të fitojë 10 ECTS për secilin vit. Në total, për periudhën e praktikës profesionale janë të dedikuara 750 orë mësimore, nga të cilat 600 orë zhvillohen në mënyrë të drejtpërdrejtë në agjencitë e sigurisë, ndërsa 150 orë janë orë pune individuale të studentit, të lidhura me përmbushjen e objektivave për secilën praktikë profesionale.

Qëllimi i periudhave praktike (Internship I, II dhe III) është të mundësojnë një lidhje të drejtpërdrejtë midis njohurive teorike të fituara gjatë studimeve dhe zbatimit të tyre në mjediset

reale të punës brenda kontekstit të sistemit të sigurisë publike, duke reflektuar mbi kompleksitetin institucional, ligjor dhe shoqëror të kësaj fushe.

Viti III	Periudha e tretë praktike (Internshipi III) 10 ECTS
Viti II	Periudha e dytë praktike (Internshipi II) 10 ECTS
Viti I	Periudha e parë praktike (Internshipi I) 10 ECTS

Tabela 3 - Struktura e periudhës së praktikës profesionale (internshipeve)

Tri periudhat e punës praktike janë:

- 1) Internshipi I - Hyrje në organizatat e sigurisë publike;
- 2) Internshipi II - Metodatat e punës dhe operacionet në shërbimet e sigurisë publike;
- 3) Internshipi III - Menaxhimi i detyrave të avancuara dhe zhvillimi i praktikave institucionale në sigurinë publike.

Internshipi I (Hyrje në organizatat e sigurisë publike): Ky modul ka për qëllim t'u ofrojë studentëve përvojë të drejtpërdrejtë në mjedisin e punës së agjencive të sigurisë publike në Kosovë, duke u njohur nga afër me funksionimin, strukturën dhe rolin e tyre. Përmes përfshirjes në aktivitete konkrete, studentët kanë mundësi të lidhin dhe të zbatojnë në praktikë konceptet e fituara gjatë lëndëve teorike, duke ndërtuar kështu një kuptim më të plotë dhe zbatues të sistemit të sigurisë publike.

Internshipi II (Metodat e punës dhe operacionet në shërbimet e sigurisë publike): Ky modul zhvillohet brenda njësisë ose sektorit ku studenti është i punësuar si zyrtar i zbatimit të ligjit dhe ka për qëllim thellimin e aftësive profesionale përmes përfshirjes në detyra të avancuara dhe lëvizjes për qëllime praktike në pozicione ose aktivitete të ndryshme brenda njësisë. Studentët analizojnë dhe zbatojnë procedurat operative, si dhe ato administrative, bashkëpunojnë me njësi të tjera dhe marrin pjesë në aktivitete planifikuese e zbatuese, duke lidhur përvojën praktike me njohuritë e fituara gjatë studimeve dhe duke avancuar profilin e tyre profesional.

Internshipi III (Menaxhimi i detyrave të avancuara dhe zhvillimi i praktikave institucionale në sigurinë publike): Ky modul ka për qëllim integrimin e plotë të njohurive dhe aftësive të fituara gjatë studimeve përmes përfshirjes në detyra komplekse brenda nivelit operativ dhe administrativ. Studentët angazhohen në analizën e proceseve të punës, asistojnë në planifikimin dhe koordinimin e aktiviteteve, bashkëpunojnë me nivele të ndryshme të strukturës organizative dhe me partnerë të jashtëm, si dhe ofrojnë rekomandime të bazuara në të dhëna për përmirësimin e praktikave institucionale.

Përmes këtyre fazave, studentët zhvillojnë kompetenca profesionale, aftësi analitike dhe qasje të integruar për menaxhimin e sfidave të sigurisë publike.

V. Periudha hulumtuese

Periudha hulumtuese, me vëllim total prej 19 ECTS, zhvillohet në vitin e tretë të studimeve dhe përbëhet nga lënda Metodologjia e hulumtimit shkencor (4 ECTS) dhe Tema e diplomës (15 ECTS). Gjatë kësaj faze, studentët përvetësojnë aftësitë metodologjike të nevojshme për hartimin e punimeve shkencore dhe aplikojnë njohuritë e fituara gjatë gjithë programit në një projekt hulumtues të pavarur. Tema e diplomës është provimi i fundit, duke shënuar përfundimin e programit dhe duke dëshmuar aftësinë e studentit për të analizuar dhe trajtuar në mënyrë profesionale një çështje specifike nga fusha e sigurisë publike.

Prioritet duhet t'i jepet temës së diplomës si një aktivitet shumë-disiplinar afatgjatë, që trajton një problem në qendër përmes hulumtimit teorik, studimit empirik ose zhvillimit të një projekti, duke adresuar nevojat praktike të fushës së studimit dhe duke u ndërlidhur ngushtë me lëndët profesionale të programit. Tema e diplomës hartohet në përputhje me Rregulloren e Studimeve Bachelor dhe mund të realizohet si punë individuale ose si pjesë e një pune të përbashkët në grup.

Tema e diplomës është rezultat i një pune të pavarur hulumtuese ose zhvillimore, të realizuar mbi bazën e metodave shkencore dhe në përputhje me standardet akademike.

Procesi i përgatitjes dhe realizimit të temës së diplomës zhvillohet në dy faza: 1) Faza përgatitore dhe 2) Faza zhvillimore.

Kush ka të drejtë të studioj në FSP

Kushtet e përgjithshme për aplikim në studimet bachelor për zyrtarët e institucioneve të sigurisë publike janë si në vijim:

Të ketë të përfunduar me sukses shkollimin e mesëm të vërtetuar me diplomë;

Të jetë i punësuar në Institucionet e Sigurisë Publike

Secili kandidat duhet të aplikoj vetëm në drejtimin përkatës nga institucioni të cilit i përket.

Kushtet e veçanta për aplikim në studimet bachelor për zyrtarët e institucioneve të sigurisë publike përcaktohen nga institucionet e sigurisë publike mbi bazën e analizës së nevojave për ngritjen e kapaciteteve të brendshme.

Me rastin e paraqitjes, kandidatët duhet t'i sjellin këto dokumente:

1. Ekstraktin e lindjes;

2. Kopjen e letërnjoftimit;
3. Kopja e kartelës identifikuese të punës;
4. Dëftesat origjinale të të gjitha klasave të shkollës së mesme dhe diploma origjinale e shkollës së mesme ose kopjet e noterizuara;
5. Nëse shkollimi i mesëm është kryer jashtë vendit duhet edhe vendimin mbi njohjen e shkollimit jashtë vendit.

Kushtet e regjistrimit të vitit akademik

Me rastin e regjistrimit, studentit i lëshohet kartela e studentit komform vendimit përkatës që rregullon pajisjen me kartela. Përfundimi me sukses i vitit në pajtim me programin e studimit është parakusht që studenti të regjistrohet në vitin tjetër.

Përrjashtimisht, kushti për regjistrimin e vitit tjetër akademik mund të arrihet edhe me minus dy provime të pa dhëna nga viti i paraprak.

Studenti i cili nuk ka mundur të përfundojë me sukses vitin duhet sërish të regjistrohet në vitin e njëjtë të studimeve. Studenti ka të drejtë të përsëris regjistrimin e vetëm një viti akademik gjatë periudhës së studimeve.

Statusi i studentit

Zyrtari i agjencinë i regjistruar në Fakultetin e Sigurisë Publike e ka statusin e studentit. Statusi i studentit dëshmohe me ID të studentit.

Studenti mund të kërkojë një herë që t'i vazhdohe kohëzgjatja e studimeve për një vit. Vendimin e merr Këshilli i Fakultetit. Në rast se merret vendim pozitiv, studenti do ta ketë sërish statusin e studentit të rregullt.

1.Studenti e humb statusin e studentit:

- 1.1 Kur vendos të largohet nga studimet;
- 1.2 Kur i ka përfunduar studimet;
- 1.3 Kur dështon të regjistrohet në vitin akademik;
- 1.4 Në rastin e përjashtimit, në bazë të vendimit të nxjerrë pas procedurës disiplinore;
- 1.5 Rastet tjera të përcaktuar në rregulloren për studimet themelore bachelor në Fakultetin e Sigurisë publike

2. Studenti mund të kërkojë pezullim të përkohshëm nga statusi i studentit të rregullt në rastet e dëshmuara si të:

1. Sëmundjes së rëndë;
2. Shtatzënisë dhe lehonisë;
3. Rastet tjera të justifikuara

Vendimin përfundimtar e merr Këshilli i Fakultetit në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të kërkesës

Studenti mund të vazhdoj studimet sërish si student i rregullt pa ndonjë pengesë në lidhje me periudhën e pezullimit të përkohshëm të statusit të studentit të rregullt. Periudha e pezullimit të përkohshëm të statusit të studentit të rregullt nuk llogaritet në kohëzgjatje e studimeve.

Kalendari akademik

- Fakultetit i Sigurisë Publike organizon studimet në pajtim me programin ekzistues të studimit gjatë vitit akademik i cili zgjat 12 muaj.
- Viti akademik fillon më 1 tetor dhe mbaron më 30 shtator.
- Periudha aktive e studimeve (ligjëratat, ushtrimet, seminarët) është e ndarë në dy semestra. Semestri dimëror që fillon më 1 tetor dhe mbaron më 15 janar dhe semestri veror që fillon më 16 shkurt dhe mbaron më 31 maj.
- Lënda ligjërohet me javë (15 javë semestri), gjatë një semestri.
- Kalendari i studimeve nxirret nga Këshilli i Fakultetit më së voni deri më 31 maj dhe përmban orarin e ligjëratave (ligjëratat, ushtrimet, seminarët), kushtet dhe afatet e provimit.

Programi i lëndës – syllabusi

Syllabusi është dokument i cili tregon përmbajtjen e një lënde mësimore dhe që ka qëllimin dhe elementet tjera udhëzuese për studentët, për llojin e mësimdhënies që ata mund dhe duhet të presin nga syllabusi. Syllabusi shpërndahet nga mësimdhënësi i lëndës te studentët në javë e parë të prezantimit të lëndës. Një syllabus duhet të përmbajë:

- Të dhënat bazike – informacionin e përgjithshëm për lëndën mësimore;
- Përshkrimin e lëndës mësimore;
- Qëllimet e lëndës mësimore;
- Rezultatet e pritura të nxënies;
- Ngarkesën e studentit në aktivitete;
- Metodologjinë e mësimdhënies;

- Metodatat e vlerësimit;
- Literatura bazë dhe literatura shtesë;
- Planin e dizajnuar të mësimin për 15 javë – kalendari i lëndës mësimore, si dhe
- Politikatat akademike dhe rregullat e mirësjelljes.

Vlerësimi i studentëve

Për përcaktimin e suksesit akademik do të aplikohen këto metoda:

1. Provimi;
2. Kolokviumi;
3. Punim seminarial;
4. Praktik profesionale;
5. Testi praktik gjatë ushtrimeve
6. Vijueshmëria;
7. Metoda tjera të përcaktuara me program studimor;

Studentët janë të obliguar dhe kanë të drejtë t'i nënshtrohen provimeve. Provimet jepen nga të gjitha lëndët, pas përfundimit të mësimin të paraparë me programin mësimor të lëndës. Studenti fiton të drejtën t'i nënshtrohet provimit nga një lëndë pasi t'i përmbushë detyrimet që lidhen me atë lëndë, të parashikuara në planin mësimor (syllabusin) të lëndës përkatëse.

Afatet e provimit

Provimet për studimet bachelor mbahen gjatë afatit të provimeve.

Afatet e rregullta të provimeve janë: afati i janarit, qershorit dhe shtatorit.

Me kërkesën e studentëve dhe miratim nga Këshilli i Fakultetit mund të mbahen edhe afatet jo të rregullta: afati i prillit dhe afati i nëntorit

Oraret e afateve të provimeve shpallen në fillim të vitit akademik dhe ato përcaktohen në atë mënyrë që studenti të mos ketë më shumë se një provim në ditë.

Oraret e provimeve pasi të jenë shpallur, janë detyruese si për mësimdhënësin ashtu edhe për studentin.

Përcaktimi i notës/vlerësimit

Suksesi i studentit në provim shprehet me nota prej 5 (pesë) deri në 10 (dhjetë).

Provimet janë publike dhe shpallen në tabelën e shpalljeve dhe në ueb faqen e Fakultetit të Sigurisë Publike.

Ndalohej hyrja në provim e personave të jashtëm, qofshin dhe anëtar të personelit universitar ose të fakultetit, me përjashtim të kordinatorit, prodekanit për çështje mësimore dhe personave tjerë të autorizuar me shkrim nga Dekani për të kryer kontroll.

Përcaktimi i notës përfundimtare të provimit bëhet në këtë mënyrë:

Pikët	Nota	Përshkrimi	ECTS Nota
91 – 100	10	Shkëlqyeshëm	A
81 – 90	9	Shumë mirë	B
71 – 80	8	Mirë	C
61 – 70	7	Kënaqshëm	D
51 - 60	6	Mjaftueshëm	E
0 - 50	5	Dobët	FX/F

studenti konsiderohet se ka kaluar me sukses provimin kur vlerësohet nga nota 6 deri në 10, ndërsa konsiderohet se nuk e ka kaluar provimin nëse është vlerësuar me notën 5.

E drejta e ankesës lidhur me vlerësimin

Studenti ka të drejtë të parashtrojë ankesë me shkrim dekanit për notën e marrë. Ankesa duhet të parashtrohet brenda dy ditëve të punës pasi të jenë shpallur rezultatet.

Studenti ka të drejtë të hyjë në riprovim në lëndën të cilën nuk e ka dhënë. Sipas rregullit, studentit ka të drejtë të hyjë më së shumti tri herë në provimin të cilin nuk e ka dhënë.

Studentit pasi të ankohet, me një arsyetim të arsyeshëm, mund t'i lejohet nga dekanit që të hyjë në provim për të katërtën herë. Provimi pastaj mund të mbahet para komisionit prej tre anëtarësh të cilët janë të emëruar nga dekanit. Po ashtu, studentët mund t'i drejtohen ombudspersonit për ndihmë apo ndërhyrje në cdo fazë dhe për cdo çështje.

Sistemi për Menaxhimin E Fakultetit (SMU)

Sistemi për Menaxhimin Universitar (SMU) është platformë elektronike e menaxhimit të të dhënave për shërbimin e studentëve.

SMU-ja përbëhet prej këtyre moduleve:

1. Moduli i aplikimit online
2. Moduli për regjistrimin e studentëve;
3. Moduli i notimit;
4. Moduli i shqyrtimit të ankesave

5. Moduli i ID kartelave të stafit dhe të studentëve;
6. Moduli i diplomave;
7. Moduli E-Karriera;
8. Moduli i mësimi online
9. Moduli E-provim.
10. Moduli i statistikave
11. Module të tjera, të cilat mund të shtohen me vendime të veçanta

SHËRBIMET STUDENTORE NË KUADËR TË AKSP – FSP-ës

Akademia e Kosovës për Siguri Publike ofron shërbime mbështetëse për nevojat arsimimit duke përfshirë, por pa u kufizuar në infrastrukturën fizike, teknologjinë informative dhe logjistikën. Poashtu, studentët kanë të drejtë në akomodim në konvikte, shujtën ditore, shfrytëzimin e bibliotekës, sallave sportive, shërbime mjekësore, si dhe shërbime tjera logjistike gjatë qëndrimit në AKSP.

Shërbimet studentore në kuadër të administratës së FSP janë të orientuara në zbatimin e kryerjes së detyrave që kanë të bëjnë me studentet në ofrimin e shërbimeve administrative, njoftimeve, këshillave si dhe menaxhimit të kërkesave të ndryshme.

Sipas kërkesave si dhe ngjarjeve të cilat zhvillohen në FSP, zyrtarët e shërbimeve studentore në mënyrë elektronike (ueb faqe të internetit) bëjnë njoftimin për oraret e ligjëratave, afateve të provimeve si dhe njoftimeve të ndryshme të cilat kanë të bëjnë me Fakultetin e Sigurisë Publike.

TË DREJTAT DHE OBLIGIMET E STUDENTËVE

Studentët që janë të pranuar në Fakultet kanë këto të drejta:

1. Të marrin pjesë në të gjitha ligjëratat, seminarët dhe në mësimet e organizuara në lëndët e programit të zgjedhur të studimit sipas mbarëvajtjes së studimeve;
2. Të shfrytëzojnë shërbimet e Akademisë.
3. Të marrin pjesë në zgjedhjet për përfaqësuesit e studentëve në organet e Fakultetit;
4. Të marrin pjesë rregullisht në mbledhjet e organeve dhe komisioneve ku janë të caktuar si anëtarë. Në rast të konfliktit të interesit në lidhje me përmbajtjen, anëtarët e deleguar të studentëve nuk marrin pjesë në takime të organeve të Fakultetit;
5. Të drejtën për të paraqitur ide të reja dhe opinione të debatueshme pa rrezikuar humbjen e vendit të studentit ose privilegjet që mund të gëzojnë nga Fakulteti;
6. Të ankohen lidhur me cilësinë e procesit të mësimdhënies ose për infrastrukturën e Fakultetit;

7. Të kundërshtuar një vendim apo një veprim të Fakultetit ndaj tyre në komision të ankesave

Studentët kanë këto detyrime:

2. T'i respektojnë legjislacionin në fuqi, të drejtat e njeriut dhe rregulloret e Akademisë;
3. T'i respektojnë të drejtat e personelit dhe të studentëve të tjerë;
4. T'u kushtojnë vëmendje të duhur studimeve të tyre dhe të marrin pjesë në aktivitetet akademike;
5. Të vijojnë ligjëratat dhe ushtrimet në pajtim me rregullat e programit specifik të studimeve;
6. Të sillen mirë si në lokalet e Universitetit, ashtu edhe jashtë tyre për të respektuar dhe ruajtur integritetin akademik të Universitetit;
7. Të respektojnë rregullat e Kodit të etikës;

OMBUDSPERSONIN E STUDENTËVE

Ombudsmani i studentëve është një pjesë shumë e rëndësishme e doracakut për studentë, sepse ofron mekanizëm të paanshëm dhe të pavarur për trajtimin e ankesave dhe shqetësimeve të studentëve. Ky rol ndihmon për të siguruar të drejtat e studentëve, promovon drejtësinë, dhe krijon një ambient më të besueshëm brenda institucionit.

Ombudspersoni është një zyrtar i pavarur i cili ofron mbështetje për studentët në rastet e padrejtësive ose shqetësimeve lidhur me proceset akademike dhe administrative në Fakultetin për Siguri Publike. Ai/a jo ndihmon në ndërmjetësim, këshillim dhe ndjekje të rasteve për të siguruar një mjedis të drejtë dhe transparent studimi. Studentët mund t'i drejtohen ombudspersonit për çështje si: vlerësimet, trajtimi nga stafi, procedurat e regjistrimit, etj.

Studentët me rregullore për Ombudspersonin e studentëve të arsimit të lartë të Akademisë së Kosovës për Siguri Publike mund t'i drejtohen Ombudspersonit në rastet kur:

1. Nuk marrin përgjigje nga njësitë përkatëse AKSP-së.
2. Ndihen të trajtuar në mënyrë të padrejtë ose diskriminuese nga stafi.
3. Hasin vështirësi në komunikim me profesorë ose zyrtarë.
4. Kanë shqetësime për etikën dhe standardet akademike.
5. Duan të këshillohen për rrugën e duhur të ndjekjes së një ankese formale.

MOBILITETI I STUDENTËVE -

Akademia e Kosovës për Siguri Publike që nga themelimi i Fakultetit të Sigurisë Publike në vitin 2014 është mjaft aktive në programin Erasmus+, si në shkëmbimin e studentëve, stafit akademik dhe atij administrativ përmes Mobilitetit Ndërkombëtar të Kredive të këtij programi, po ashtu edhe në pjesëmarrje në ngjarjet që organizohen nga Zyra e Erasmus+ në Kosovë.

Kështu, nga viti 2016 e deri në fund të vitit 2024, përmes Mobilitetit Ndërkombëtar të Kredive të programit Erasmus+, Akademia e Kosovës për Siguri Publike ka arritur të dërgojë jashtë vendit dhe të pranojë brenda vendit për qëndrime në periudha të ndryshme kohore gjithsej 126 studentë, pjesëtarë të stafit akademik e administrativ të AKSP-së dhe institucioneve partnere (përfshirë dhe zyrtarë të Policisë së Kosovës). Prej tyre, 99 janë shkues, kurse 27 ardhës.

Shkëmbimet janë zhvilluar në institucionet si në vijim: Akademia e Estonisë e Shkencave të Sigurisë, Universiteti i Shkencave të Aplikuara të Policisë në Brandenburg të Gjermanisë, Akademia e Zjarrfikjes në Varshavë të Polonisë, Kolegji Universitar Policor i Norvegjisë, Universiteti i Shkencave të Aplikuara Laurea i Finlandës dhe Fakulteti i Sigurisë i Shkupit i Universitetit St. Kliment Ohridski i Manastirit të Maqedonisë së Veriut.

VEPRIMTARIA E RRJETIT ALUMNI

Fakulteti për Siguri Publike (FSP) mbështet dhe inkurajon krijimin e një komuniteti të fuqishëm të **alumnive**, me qëllim që të ruajë lidhjet e vazhdueshme me ish-studentët dhe të nxisë bashkëpunimin profesional dhe akademik. Alumni-t e FSP-së do të jenë një pjesë e rëndësishme e historisë dhe zhvillimit të institucionit, duke kontribuar në ngritjen e reputacionit të tij në shoqëri.

Me rregulloren për “*Organizimin dhe Funksionimin e Rrjetit të Alumni të Akademisë së Kosovës për Siguri Publike*” është krijuar mundësia ligjore dhe përcaktimi i rregullave për organizimin dhe funksionimin e Rrjetit të Alumni-t, si një strukturë përfaqësuese dhe këshillëdhënëse e ish-studentëve të arsimit të lartë të diplomuar në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike e cila në veprimtarin e Rrjetit Alumni përfshin:

1. Ruajtjen dhe zhvillimin e lidhjeve ndërmjet AKSP-së dhe ish-studentëve të saj të arsimit të lartë;
2. Dhënien e këshillave dhe rekomandimeve për zhvillim të AKSP-së;
3. Krijimin e rrjeteve profesionale dhe bashkëpunimeve në fushën e sigurisë publike;

4. Promovimin e vlerave të arsimimit në siguri publike dhe etikës profesionale;

KËSHILLI I STUDENTËVE TË FSP

Këshilli i studentëve është organi ku përfaqësohen dhe adresohen interesat e studentëve.

Detyrat dhe përgjegjësitë e këshillit të studentëve janë brenda fushave të caktuara, për të shprehur mendime dhe propozime për të gjitha problemet me interes të përgjithshëm.

Përbërja e Këshillit të Studentëve

Këshilli i studentëve themelohet si rezultat i zgjedhjeve të studentëve të Fakultetit të Sigurisë Publike i cili përbëhet prej shtatë (7) anëtarëve.

Këshilli i studentëve obligohet t'i adresoj çështjet e ngritura nga studentët në organet përkatëse të AKSP dhe Këshillin e Fakultetit si antare/ë me të drejtë vote vetëm në çështjet studentore.

Këshilli i studentëve nuk mund të organizohet në struktura politike e jopolitike jashtë AKSP. Më detajisht rreth punës dhe përgjegjësiave të këshillit të studentëve ju mund të ju referoheni Rregullores Nr. 02/2016 mbi punën e këshillit të studentëve në Fakultetin e Sigurisë Publike

Procedura e diplomimit

Përfundimi i studimeve bachelor

1. Studenti fiton të drejtën të marrë temën e diplomës pasi t'i ketë dhënë provimet e parapara me plan programin studimor por nuk mund ta mbroj para se ta përfundon intershipin e tretë.
2. Programet e studimeve bachelor përfundojnë me punimin e diplomës për bachelor në pajtim me programet e studimeve.
3. Punimi i diplomës në studimet bachelor elaborohet individualisht nga studenti duke vërtetuar se aftësitë teorike të arritura gjatë kohës së studimeve mund të shfrytëzohen me sukses për zgjedhjen e problemeve praktike në fushën për të cilën është përcaktuar studenti.
4. Procedura për aplikim, elaborim, mbrojtje dhe vlerësim të punimit të diplomës për bachelor përcaktohet me rregulloren për studimet themelore bachelor në Fakultetin e Sigurisë Publike.
5. Studenti që i jep të gjitha provimet e parapara me planin mësimor dhe i kryen obligimet tjera të parapara me akte normative të Fakultetit, si dhe e mbron me sukses temën e

diplomës, në rast se është e përcaktuar me programin e studimeve, fiton gradën bachelor në Sigurinë Publike.

6. Diplomën për kryerjen e studimeve bachelor e nënshkruan Drejtori i Akademisë dhe Dekani i Fakulteti i Sigurisë Publike

KAMPUSI I AKSP

Kampusi i AKSP përbëhet nga objektet bazë dhe atyre përcjellëse. Në të gjitha objektet e kampusit të AKSP kërkohet pasqyrimi, paraqitja dhe qëndrimi i studentëve sipas standardeve të kërkuara në hapësirat e AKSP.

Disa nga objektet e kampusit të AKSP i kemi paraqitur në vijim:

- Ndërtesa administrative.
- Ndërtesa kryesore.
- Biblioteka.
- Sallat sportive.
- Konviktet/fjetoret.
- Mensa/kuzhina.
- Ambulanca dh shërbimet mjekësore.
- Poligonet dhe dhoma e simulimit me armë zjarri (STAZ)

NDËRTESA ADMINISTRATIVE

Në objektin e Administratës janë të vendosur Menaxhmenti i AKSP-së dhe nëpunës tjerë të cilët merren me mbarrëvajtjen e punëve të AKSP-së. Ky objekt ka sipërfaqe prej 621.2 m2 dhe posedon infrastrukturën bashkëkohore.

NDËRTESA KRYESORE

Ndërtesa kryesore është objekti kryesor dhe ka gjithsej 20 klasë mësimi të cilat janë të pajisura me projektorë, kompjuterë dhe kanë mbulim të plotë me wi-fi.

Në kuadër të kampusit është funksionalizuar edhe objekti i Fakultetit të Sigurisë Publike, i cili ka ne dispozicion amfiteatër dhe klasa moderne. Në funksion të nevojave të studentëve është kabineti i kompjuterëve i cili ka 30 kompjuterë, smartboard dhe projektor.

Çdo klasë, në këtë objekt, ka nga 15 tavolina dhe 30 karrige, që do të thotë se në një klasë mund të i ndjekin në kushte optimale mësimet 30 kadetë/student/vijues të trajnimeve.

Pjesë e ndërtesës kryesore po ashtu është edhe një numër i konsiderueshëm i zyrave të cilat shërbejnë për nëpunësit e administratës të cilët veprojnë në kuadër të AKSP-së.

BIBLIOTEKA

Funksionet dhe detyrat e bibliotekës - Biblioteka siguron materiale, informacione e shërbime bibliotekare në funksion të trajnimit dhe arsimit të lartë të cilat i ofron AKSP dhe të zhvillimit të aftësive të studentëve dhe të personelit trajnues e mësimdhënës.

Biblioteka ofron huazimin e librave dhe materialeve të tjera, shërbime informuese, aftësimin e lexuesit për përdorimin e bibliotekës si dhe hapësirën për lexim.

Shfrytëzimi i bibliotekës - Studentët e Fakultetit për Siguri Publike kanë të drejtën e shfrytëzimit të bibliotekës dhe huazimit të materialeve bibliotekare

Salla e leximit në Bibliotekë - Përdoruesi i cili shfrytëzon sallën e leximit të Bibliotekës duhet të regjistrohet në formularin ditor të regjistrimit në Bibliotekë gjithashtu në sallën e leximit janë të instaluar 10 kompjuterë për lexim, përgatitje të provimeve dhe seminareve.

- **Afatet e huazimit** - periudha e huazimit të materialeve është jo më shumë se 20 ditë kalendarike, në maksimum prej tre (3) tituj.
- **Periudha e huazimit** mund të vazhdohet edhe për afatin e dytë, në rast se libri nuk është rezervuar paraprakisht nga dikush tjetër.
- **Certifikata/Diploma** nuk do t'i jepet studentit përderisa nuk i kthen të gjitha librat e bibliotekës dhe nuk ka ndonjë detyrim ndaj bibliotekës.
- **Titujt e librave** - të gjithë titujt duhet të regjistrohet në kartelën personale dhe të nënshkruhet nga përdoruesi, i cili merr përsipër të zbatojë dispozitat e kësaj rregulloreje dhe të mos u japë personave të tretë titujt që ka huazuar.

Biblioteka në raste të veçanta ka të drejtë:

- a) Që të vendosë një afat më të shkurtër huazimi.
- b) Të ndalojë materiale për huazim.
- c) Të kërkojë materialin para skadimit të afatit të kthimit.

Dorëzimi me vonesë, dëmtimi apo humbja e materialeve - në rast moskthimi në afat të materialeve, përdoruesi nuk mund të huazoj material përderisa nuk e kthen materialin si dhe i pezullohet për një (1) muaj shërbimi i huazimit të materialeve nga momenti i kthimit të materialit. Ndërsa, *përdoruesi që ka humbur apo dëmtuar një material, , është i detyruar ta zëvendësojë atë me një vëllim të njëjtë.*

SALLA E SPORTEVE

Objekti i palestrës sportive ka sipërfaqe prej 1222.68 m² e cila mundëson zhvillimin e aktiviteteve sportive për të gjithë studentët vijues të Programit Bachelor si dhe përdoret edhe për mbajtjen e testit pranues, poashtu në këtë objekt gjendet edhe salla dhe hapësira me pajisje fitnesi.

Sallat sportive në AKSP mund të shfrytëzohen nga studentët sipas orareve të përgatitura Shërbimi Studentor për zhvillimin e aktiviteteve si: volejboll, futboll, basketboll, hendboll, ping-pong, ngritja e peshave etj., por gjithnjë duke mos penguar mbarëvajtjen e procesit mësimorë.

Në sallat sportive është e ndaluar:

- a) Hyrja në sallat e sportit me këpucë jo sportive si dhe të mbathura tjera nga të cilat mund të dëmtohet dyshemeja.
- b) Përdorimi i pajisjeve sportive pa lejen e personave përgjegjës të sallës së sportit.
- c) Demolimi dhe dëmtimi i aseteve trajtohet sipas procedurave përkatëse ne fuqi si dhe
- d) *Pajisjet e përdorura gjatë ushtrimeve të ndryshme duhet të kthehen në vendet e tyre përkatëse.*

KONVIKTET

Konviktet në AKSP shërbejnë për akomodimin e dhe në kuadër të kampusit të AKSP-ëe gjenden këto konvikte si ne vijim:

- a) **Konvikti/fjetorja për meshkuj** - konvikti i dedikuar për gjininë mashkullore.
- b) **Konvikti/fjetorja për femra**
- c) **Konvikti/fjetorja për PNL** - konvikt i dedikuar për persona të nivelit të lartë.

Të interesuarit për akomodim paraprakisht do të ngarkohen individualisht me pajisen përkatëse të fjetjes nga DFSHP si: batanije, jastëk, çarçafët, etj.

Dhomat në konvikte - Studentët do të jenë përgjegjës për pastërtinë e dhomave të tyre të fjetjes, dhe nuk lejohet të ndryshojnë dhomën e përcaktuar të gjumit e cila nuk u është caktuar nga personeli. Poashtu, *pajisjet për përgatitjen e ushqimit, për nxehjen e pijeve ose për ngrohje janë të ndaluara ne konvikte/fjetore.*

Fjetja në konvikte të AKSP - Orët e qetësisë (përfshirë edhe “shkyçjen e dritave” në dhoma) duhet të respektohen në konvikte prej orës 22:00.

Është e ndaluar pjesëmarrja në aktivitete të zhurmshme dhe të pakontrolluara, me të cilat pengohet, shqetësohet ose bezdiset cilido person tjetër në AKSP.

MENSA/KUZHINA

Për të shfrytëzuar të drejtën e shujtës ditore, studenti duhet të jete i pajisur me kartelën elektronike për qasje në kuzhinë.

Shujta ditore - e drejta në shfrytëzimin e tre racioneve ushqimore në AKSP ju takon studentëve të cilët janë të akomoduar në konvikte në AKSP, ndërsa shujta vetëm e drekës ju takon atyre studentëve të cilët nuk janë të akomoduar në konvikte të AKSP. *Shujtat ju takojnë studentëve nga fillimi i semestrit deri në përfundim të semestrit.*

Objekti i mensës përfshin sipërfaqe prej 548.75 m² dhe shërben për të ofruar racione ushqimi.

AMBULANCA DHE SHËRBIMET MJEKËSORE

Sektori i mjekësisë është sektori ku ofrohet ndihma e parë mjekësore dhe trajtimi studentëve dhe personelit të AKSP gjatë orarit të mësimi/punës në AKSP.

Ky sektor është referues dhe shoqërues për shërbime mjekësore në rastet kur vlerësohet nevoja e specialisteve të lëmive gjegjëse në mjekësi.

Sektori është i pajisur me mjekun e përgjithshëm dhe dy motra-teknike të mjekësisë së përgjithshme dhe gjithashtu posedon edhe auto-ambulancën.

POLIGONET DHE STAZ

AKSP posedon poligonin e vozitjes, poligonet e qitjes tipit të hapur dhe të mbyllur, si dhe dhomën e simulimit të trajnimit me armë zjarri

Të gjitha aktivitetet të cilat zhvillohen në këto hapësira janë të rrezikshmërisë së lartë andaj edhe rregullat duhet të përcillen në mënyrë eksplicite sipas komandës së dhënë nga instruktori/zyrtari i armëve të zjarrit, armëtari dhe përgjegjësi i dhomës së simulimit e të trajnimit me armë zjarri.

Ky doracak do të shërbej si mjet lehtësues në përdorim të studentëve për të qenë të informuar dhe për të marr vendime individuale lidhur me të gjitha proceset që i përcjellin studentët gjatë studimeve. Manuali do të publikohet në ueb faqen e FSP–ës.

Adresa:

Akademia e Kosovës për Siguri Publike – Fakulteti për Siguri Publike
Rr. Gjergj Kastrioti Skënderbeu, p.n. 42000 Vushtrri,
Republika e Kosovës
Tel: +383 (0)28 590 070
web: <http://aksp.rks-gov.net>